



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01/2020
Klinë, dt.16.03.2020

Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazeten zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, si dhe vendimin nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, me akordin e grupit për gatishmëri emergjente të datës 16.03.2020, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 16.03.2020, merr;

V E N D I M

1. **LEJOHET**, lëvizja e qytetareve të Komunës së Klinës brenda territorit të saj për raste të nevojave urgjente dhe të domosdoshme me qëllim të kryerjes së shërbimeve të caktuara. Për lëvizjet e nevojshme të gjithë duhet të jenë të pajisur çdo here me dokumente të identifikimit.
2. Qytetaret me qëllim të mbrojtjes nga pandemia obligohen t'i shmangin lëvizjet e panevojshme dhe t'u përmbahen obligimeve dhe udhëzimeve të dala nga niveli qendror dhe lokal.
3. Vendimi i është i plotfuqishëm dhe do të zbatohet menjëherë.
4. Zbatimi i këtij vendimi behet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me akteret tjerë përgjegjës.

Te njoftohet:

- Policia e Kosovës- Klinë;
- Grupi për gatishmëri emergjente;
- Publiku.



Kryetari,
Zemir Elezaj